Atë që i fal rregullisht katër rekate para drekës dhe katër pas saj, Allahu do ta ndalojë atë nga zjarri i Xhehenemit

Umu Habibja, gruaja e Profetit ﷺ, transmeton se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut ﷺ duke thënë: "Atë që i fal rregullisht katër rekate para drekës dhe katër pas saj, Allahu do ta ndalojë atë nga zjarri i Xhehenemit."

[Sahih] [رواه أبو داود والترمذي والنسائي وابن ماجه وأحمد]

Profeti ﷺ në këtë hadith e përgëzoi atë që i fal katër rekate nafile (vullnetare) para namazit të drekës dhe katër rekate nafile pas tij, duke i falur ato në vazhdimësi, Allahu do ta ndalojë atë nga zjarri i Xhehenemit.

http://sunnah.global/hadeeth/sq/show/11251